

VENDIM
Nr. 57, datë 28.10.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 6, DATË 3.2.2017, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
GJIROKASTËR”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 3.2.2017 ‘Për licencimin e sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër (UK Gjirokastër), me shkresën nr. 983 prot., datë 9.9.2019, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Gjirokastër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe me procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Gjirokastër, me vendimin nr. 6, datë 3.2.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Gjirokastër sh.a. z. Gentian Llogo, ka mbaruar studimet e larta në “Ekonomi”, dega “Financë kontabilitet”, si dhe master për “Financë bankë”.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Gjirokastër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 3.2.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor z. Gentian Llogo”,
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani